



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Agim Morina” B.I. e datës 11.07.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “112 Ndërtimi i rrugëve në fshatin Mramor” me nr. të prokurimit 616-24-3056-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Agim Morina” B.I. e datës 11.07.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “112 Ndërtimi i rrugëve në fshatin Mramor” me nr. të prokurimit 616-24-3056-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHE** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik “Agim Morina” B.I. (tutje “parashtruesi”) me datë 11.07.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 08.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “112 Ndërtimi i rrugëve në fshatin Mramor” me nr. të prokurimit 616-24-3056-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet kryesore ankimore të parashtruesit:

**Pretendimi 1:** "AK arsyen e parë të eliminimit e ka cekur në njoftimin për vendimin e AK ku ne bazë të njoftimit ne nuk e kemi plotësuar ANEKSIN 7, konkretisht listen e projekteve të realizuara. SQARIM: Në ofertën që kemi dorëzuar, konkretisht nr. rendor 7. Kontratat Burimi, kemi paraqitur sakt dhe qart një listë të kontratave të cilat janë realizuar duke e përmbushur edhe kërkesën e dosjes se tenderit. Plotesimi i ANEKSIT 7 është i barazolefshem me Listen e Kontratave të realizuara nga kompania N.N.NT BURIMI/Agim Morina B.I, e cila është e nënshkruar dhe vulosur (origjinal)".

**Pretendimi 2:** "Tek pika 4. Udheqesi i punimeve Meqenese ne kemi prezantuar Ing. e ndertimtarisë/Konstruktiv, AK ka mundur që të kërkon informata sqaruese lidhur me vendimin për udheqes të punimeve. Sa i përket kërkesës 7. Të dosjes se tenderit, konkretisht Një (1) Ripper (Gremq), sqarojm se kjo paisje nuk ka nevoj te paraqitet ne listen e mjeteve sepse është pjesë përcjellese e eskavatorit, por si deshmi e kemi paraqitur faturën me nr. 8, Datë: 07.05.2011. Emertimi lugë (kova) vjen sipas regjistrimit ne doganë dhe nuk percaktohet nga ne. Pra paisja e cila kërkohet ne dosjen e tenderit është pjes e paisjeve tona dhe si te till ju sugjerojm edhe ta bëni një vizitë tek ne dhe të vertetohet kjo paisje. Gjithashtu sa i përket Një (1) Dozer (Buldozher) pesha 18-20 ton kemi paraqitur një faturë me nr. 002/20 të datës 10.12.2020 Ndersa Një (1) Cilinder për asfalt gome hekur e kemi paraqitur si foto me të dhëna".

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

**[Tenderi i juaj] është i papërgjegjshme**

- Nuk keni plotësuar kërkesat e DT-së dhe Njoftimit për kontrate, Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale.

ARSYETIM

**Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:**

- Ju si GOE-ik nuk keni plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 dhe 9.2 pika 1 ku është kërkuar: *1.Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses Kontrata ne vlere minimale 150,000.00 € te shërbimeve te ekzekutuara ne lëmine e fushës së kontratës apo të ngjashme, për tre vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontrate. Për grupin e Operatoreve Ekonomik, lideri duhet ti plotësoi 60% te kërkesës. Deshmia e kerkuar: 1.Një liste te kontratave të realizuar duke plotësuar Aneksin 7 të DT-së lista e kontratave dhe referenca ose pranime teknike për shërbime në lëmin e kërkuar apo të ngjashme, për 3 (tre) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontrate, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhien e shërbimeve (Kontrata dhe Referencat duhet te korrespondojnë me njëra tjetrën). Ju si GOE-ik nuk e keni plotësuar Aneksin nr 7 të listës së projekteve; pra ai aneks mungon dhe jeni te papërgjegjshëm administrativisht..*

- Ju si GOE-ik nuk keni plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 dhe 9.2 **pika 4** ku është kërkuar: *4.Udhëheqës i punishtes (kontratës) Vërejtje Udhëheqësi duhet të jetë me profesion nga fusha e inxhinierisë së ndërtimit – Drejtimi Konstruktivë, Deshmia e Kërkuar: 4. •Diplomë universitare e programit min. Bachelor •Biografia (CV-në) e nënshkruar nga kandidati; •Një (1) kontratë të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme, duhet të jenë të bashkangjitura referencat. •Kontratën e punës të përhershme ose për këtë kontratë me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; •Përvojë pune profesionale të fushës së kontratës apo të ngjashme, min.3 vite pas diplomimit, duhet të dëshmohet përmes kontratës (Kontratave me punëdhënësit) së punës; •Certifikat për Siguri dhe Shëndeti në Punë. Ju si GOE- për këtë pike të kërkesës keni paraqitur disa inxhinier të ndryshëm por nuk e keni specifikuar me vendim udhëheqësin e punishtes edhe kjo pike është e paplotësuar nga ju si GOE-ik).*
- Ju si GOE-ik nuk keni plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 dhe 9.2 **pika 7.** ku është kërkuar: *7.Lista e pajisjeve profesional të OE. •Katër (4) Kamionë për transport • Një (1) Ekskavator për gërmim dhe ngarkim me goma 18-20ton •Një (1) Ekskavator për gërmim dhe ngarkim me zinxhir me pesh 18-20 ton •Një (1)Mini Ekskavator me cekan me pesh 1-1.5ton •Një (1) Cilinder për vibrim 19 -21 ton • Një (1) Dozer (Bulduzher 18-20 ton •Një (1) Grejder •Një (1) Finisher •Një (1) Cilinder për asfalt gome-heker pesh 2-2.5 ton •Një (1) Cilinder për asfalt heker heker pesh mbi 8 ton •Një (1) Ripper (Gremq) për eskavator me pesh 18-20ton •Një (1) Ngarkues me pesh 5-6ton. Deshmia e kërkuar: 7.Lista e pajisjeve profesional të OE. Aneksi 8 i DT. Duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik. Për pajisjet OE. duhet të prezantohet njërin nga këto dokumente Për automjetet që nuk regjistrohen Deklaratat unike doganore apo faturat e blerjes, të gjitha ato mjete që paraqiten me faturë të blerjes duhet të kenë të bashkangjitur edhe dud-in doganor. Për automjetet që regjistrohen Librezat e qarkullimit me validitet. Në rast se OE. nuk posedon pajisjet mbi pronësinë atëherë OE. duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve me dëshmitë sipas kërkesës me lartë. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të këtij projekti e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët po ashtu marrëveshja duhet të jetë e noterizuar. Të dhënat për pajisjet (viti i prodhimit, gjendja e pajisjes, kamionat, regj.i targave, mekanizimi)s Ju si GOE-ik për pikën e kërkesës Një (1) Dozer (Bulduzher 18-20 ton keni paraqitur disa buldozer të cilët nuk plotësojnë kërkesën e DT-se, pasi keni paraqitur bulduzer me peshe 25 ton dhe me peshte 13 ton. Për pajisjen e kërkuar Një (1) Cilinder për asfalt gome-heker pesh 2-2.5ton, kjo pajisje ju mungon ju si GOE-ik nuk keni paraqitur listën e makinerisë së specifikuar për këtë projekt, pajisja e kërkuar mungon nuk është në listë poashtu edhe nuk është në dokumentacionin e dorëzuar nga ju, edhe për këtë pike jeni të papërgjegjshëm. Për pikën e kërkesës Një (1) Ripper (Gremq) për eskavator me pesh 18-20ton, kjo pajisje nuk është paraqitur në liste të mjeteve të specifikuara, edhe pas sqarimeve të kërkuara nga AK GOE-ik ka paraqitur një faturë dhe përshkrimi i saj është lagë (kovë), pra nuk është mjete i njëjtë siç është kërkuar në DT, edhe për këtë pike GOE-ik është i papërgjegjshëm. Andaj për arsye të cekura më lartë jeni eliminuar nga ky Aktivitet i Prokurimit.*

**Lidhur me pretendimin 1** - ky pretendim i referohet arsyes së parë për eliminim. Për parashtruesin nuk është kontestues fakti që nuk është dorëzuar lista e kontratave sipas aneksit 7 por parashtruesi pretendon se lista e kontratave që ka dorëzuar është ekuivalente me listën e kontratave sipas aneksit 7. Lidhur me këtë fakt duhet sqaruar se as për AK nuk është kontestues fakti që është dorëzuar një listë e cila është dorëzuar nga vet parashtruesi. Mirëpo komisioni vlerësues ka gjetur se në këtë rast parashtruesi nuk ka plotësuar me rregull formularin e tenderit respektivisht aneksin 7 të dosjes së tenderit që ka të bëjë me listën e kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit. Përmes pikës 10 të UPP është përcaktuar se plotësimi i formularit të tenderit është kusht administrativ prandaj në rastet kur formulari i tenderit mungon ose nuk plotësohet si duhet, tenderi refuzohet si administrativisht i papërgjegjshëm pa kërkuar sqarime shtesë.

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
--	---	---------------------

**Lidhur me pretendimin 2** - ky pretendim i referohet arsyes së dytë dhe të tretë për eliminim. Sa i përket arsyes së dytë për eliminim, pas administrimit me ofertën e parashtruesit është gjetur se në ofertë mungon vendimin për udhëheqësin e punishtes sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit se AK është dashur që të kërkojë sqarime shtesë dhe të lejoj që një vendim i tillë të dorëzohet pas hapjes së ofertave, fillimisht duhet cekur se sqarimet në kuptim të nenit 72 të LPP nuk mund të kërkojë mbi bazën e një dokumenti që nuk ekziston. Si shembull, po të ishte dorëzuar vendimi për udhëheqës dhe nëse AK kishte për të pasur ndonjë paqartësi lidhur me përmbajtjen e vendimit, atëherë do të mund të kërkohej sqarime shtesë por nuk mund të kërkohej sqarime për diçka që nuk është dorëzuar pasi që dorëzimi i vendimit në këtë formë pas hapjes së ofertave do të përbënte ndryshim material të ofertës së parashtruesit dhe kjo është absolutisht e ndaluar me LPP. Ndërsa sa i përket arsyes së tretë për eliminim, pas administrimit me ofertën e parashtruesit është gjetur se parashtruesi ka prezantuar disa buldozer të cilët nuk i plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit për buldozer 18-20 pasi që buldozerët e parashtruesit janë me nga 13 ton ose me nga 25 ton. Për pajisjen cilindër për asfalt gome-hekur 2-2.5 ton, kjo pajisje mungon tërësisht (nuk është as në listë as në dokumentacion). Tutje Ripper (Gremq) për eskavator me peshë 18-20 ton, as kjo pajisje nuk është paraqitur në listën e mjeteve sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Pavarësisht faktit nëse kjo pajisje përdoret si e mëvetësishme apo si pjesë e bashkangjitur me eskavator, në dosjen e tenderit është kërkuar që kjo pajisje të evidentohet si pajisje e pavarur në listën e pajisjeve. Këtë nuk e ka bërë parashtruesi. Për më tepër, edhe pas sqarimeve të kërkuara nga AK, parashtruesi ka paraqitur një faturë për lugë (kovë) dhe jo për riper me peshë 18-20 ton sipas DT. Rrjedhimisht është gjetur se parashtruesi nuk ka plotësuar as këto kërkesa të DT.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme pasi që nuk ka përmbushur kërkesat e dosjes së tenderit. Njëkohësisht nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.



Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 15.07.2024**

**Visar SHEHU**



Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.